


**CFRR** >>

Centre for Financial  
Reporting Reform




**STAREP**



Konferenca Ministrore 2022

**KOMUNITETI I PËRBASHKËT I  
PRAKTIKËS SË KONTABILITETIT DHE  
AUDITIMIT: AVANCIMI I RAPORTIMIT  
FINANCIAR, AUDITIMIT DHE ZBATIMI I  
STANDARDEVE TË QËNDRUESHMËRISË**

1 dhjetor 2022 • Vjenë, Austri







Konferenca Ministrore 2022

# KOMUNITETI I PËRBASHKËT I PRAKTIKËS SË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT: AVANCIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR, AUDITIMIT DHE ZBATIMI I STANDARDEVE TË QËNDRUESHMËRISË

1 dhjetor 2022 • Hotel Marriot Vjenë, Austri

## PARATHËNIE

Ky seminar i Komunitetit të Praktikës së Kontabilitetit dhe Auditimit (A&A CoP) zhvillohet në kuadër të dy programeve kryesore të Qendrës së Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (QRRF): Forcimi i Auditimit dhe Raportimit në Partneritetin Lindor (STAREP) dhe Programi Rruga drejt Evropës për reformën e Kontabilitetit dhe forcimin institucional për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (REPARIS for SMEs).

STAREP është një program rajonal për vendet e Partneritetit Lindor që filloi në tetor 2013 dhe pritet të zgjasë deri në fund të vitit 2022 me ndihmën e fondeve shtesë të ofruara nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Ky program ka ndihmuar në nisjen dhe zbatimin e reformave kritike për përmirësimin e kornizave të raportimit financiar në vendet përfituese që synojnë forcimin e praktikave të menaxhimit financiar në sektorin privat dhe midis ndërmarrjeve shtetërore, rritjen e cilësisë së këshillimit dhe auditimit të biznesit nga profesioni i kontabilitetit dhe auditimit dhe duke mbështetur një mjedis më të favorshëm që mundëson biznes dhe qasje të përmirësuar në financa. Punëtorja do të diskutojë mësimet e nxjerra dhe përvojën e fituar si pjesë e programit STAREP, si dhe sfidat e planet e ardhshme.

REPARIS for SMEs është një program gjithëpërfshirës rajonal i zhvillimit të kapaciteteve për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ai synon të përmirësojë qasjen e NVM-ve në shërbimet profesionale të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar dhe të mbështesë përafrimin e kornizave kombëtare të raportimit financiar të korporatave me direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian (BE). Programi financohet nga BE. Punëtorja do të shërbejë si një platformë për një nisje formale të aktiviteteve të projektit dhe do të diskutojë dhe bie dakord mbi hapat e ardhshëm.

Ky event është një mundësi për pjesëmarrësit që të komunikojnë drejtpërdrejt me ekspertët e përfshirë në hartimin e Standardeve Evropiane të Raportimit të qëndrueshmërisë (ESRS) si pjesë e propozimit të Komisionit Evropian (KE) për Direktivën e raportimit të qëndrueshmërisë së Korporatave, dhe në përputhje me paketën e financave të qëndrueshme të KE-së. Kjo me objektiva për të riorientuar flukset e kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme për të arritur një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse si psh menaxhimi i rreziqeve financiare që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, varfërimi i burimeve, degradimi i mjedisit dhe çështjet sociale, etj. Poashtu që të nxisë transparencën dhe jetëgjatësinë në aktivitetin financiar dhe ekonomik. Eventi do të diskutojë edhe ndikimin e çështjeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (MSQ) në performancën e NVM-ve.

Punëtorja do të përditësojë pjesëmarrësit mbi parimet themelore të rishikuara të miratuara nga anëtarët e forumit ndërkombëtar të rregullatorëve të pavarur të auditimit (IFIAR). Parimet themelore shërbejnë si një udhëzues për mbikëqyrjen e mirë të auditimit dhe mund të përdoren nga rregullatorët e auditimit dhe palët e tjera të interesuara. Gjithashtu do të diskutohen zhvillime të tjera në fushën e mbikëqyrjes publike dhe sigurimit të cilësisë.

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK) gjithashtu dëshiron të ofrojë perspektivën e saj globale për raportimin e qëndrueshmërisë. Poashtu do të diskutohet nevoja për një mentalitet të integruar dhe të qenit proaktiv në të kuptuarit e kërkesave të raportimit të klimës dhe praktikave më të mira globale, përfshirë rolin dhe perspektivat për praktikën e vogla dhe të mesme (PVM) që u shërbejnë NVM-ve.

Përkthimi simultan do të jetë i disponueshëm në shqip, boshnjakisht/kroatisht/serbisht dhe rusisht.

## AGJENDA

**08:30** | Regjistrimi dhe kafe

**09:00** | Hyrje

### Folës

- **Iwona Warzecha**, Specialiste e lartë e menaxhimit financiar, Udhëheqëse e Ekipit në REPARIS for SMEs, Banka Botërore

**09:15** | Shqyrtim mbi aspektet e qëndrueshmërisë: Kërkesat e reja të raportimit dhe auditimit

### Folës

- **Gemma Sanchez-Danes**, Zëvendës Udhëheqëse e Sekretariatit për raportim të qëndrueshëm, Grupi Këshillimor Evropian për Raportim Financiar (EFRAG)

### Moderator

- **Garik Sergeyan**, Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Udhëheqës i Ekipit në STAREP, QRRF, Banka Botërore

### Temat në fokus

Ekziston një propozim për një direktivë të BE-së<sup>1</sup> që ndryshon Direktivën 2013/34/BE, Direktivën 2004/109/EC, Direktivën 2006/43/EC dhe Rregulloren (BE) Nr 537/2014 në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave. Bordi Raportues i mbi qëndrueshmërisë i EFRAG dhe Grupi i ekspertëve teknik të Raportimit të Qëndrueshmërisë EFRAG kanë zhvilluar një grup të parë të ESRS<sup>2</sup> që do të miratohet nga KE. Qëllimi i këtij sesiioni është të ofrojë informacion mbi përmbajtjen e standardeve të reja dhe zbatueshmërinë e tyre dhe mbi kërkesat përkatëse të auditimit. Prezantimi do të pasohet nga një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh.

<sup>1</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52021PC0189>

<sup>2</sup> <https://www.efrag.org/Activities/2105191406363055/Sustainability-reporting-standards-interim-draft>

10:15

## Ndikimi i çështjeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në performancën e NVM-ve

### Folës

- **Erik Vermeulen**, Profesor, Fakulteti Juridik Tilburg, Departamenti i Legjislacionit Privat, Biznesor dhe të punës

### Moderatore

- **Iwona Warzecha**, Specialiste e Lartë e Menaxhimit Financiar, Udhëheqëse e Ekipit në REPARIS for SMEs, Banka Botërore

### Temat në fokus

Qëllimi i këtij sesiioni është të diskutojë se si strategjitë e MSQ dhe raportimi i MSQ (dhe dialogu MSQ) mund të ofrojnë zgjidhje për problemet e shumta me të cilat përballen NVM-të në botën e sotme – veçanërisht në tërheqjen dhe mbajtjen e investitorëve, punonjësve dhe klientëve. Gjithashtu do të diskutohet ndikimi i MSQ në performancën e NVM-ve. Prezantimi do të pasohet nga një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh.

11:15

## Kafe dhe pushim për rrjetëzim

11:45

## Parimet themelore të Auditimit për Rregullatorët e pavarur

### Folësit

- **Melissa Andrade Gomes**, Zyrtare e Lartë për Politika, Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFIAR)
- **Michael Komarek**, Drejtor Ekzekutiv, Autoriteti Austriak i mbikëqyrjes së Auditimit (APAB)

### Moderator

- **Andrei Busuioc**, Specialisti i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

### Temat në fokus

Parimet Themelore të IFIAR synojnë të promovojnë mbikëqyrje efektive të auditimit të pavarur në nivel global, duke kontribuar kështu në një objektiv kryesor për t'i shërbyer interesit publik dhe për të rritur mbrojtjen e investitorëve duke përmirësuar cilësinë e auditimit. Parakushti kryesor për një sistem efektiv të mbikëqyrjes së auditimit dhe rregullimit të auditimit është ekzistenca e një kuadri ligjor dhe të qeverisjes korporative të zhvilluar mirë që ofron mbështetjen e nevojshme për auditim me cilësi të lartë. Ky sesion do të informojë pjesëmarrësit për: (i) grupin e rishikuar të Parimeve Themelore të IFIAR,<sup>3</sup> duke reflektuar përparimet në mbikëqyrjen e auditimit që nga fillimi i zhvillimit të Parimeve Themelore të IFIAR në 2011; (ii) kategorinë e anëtarëve të asocuar të ristrukturuar të IFIAR; dhe (iii) rezultatet e Anketës së gjetjeve të Inspektimit 2021, që rrjedhin nga inspektimet individuale të rregullatorëve anëtarë të IFIAR të firmave të auditimit të lidhura me gjashtë rrjetet më të mëdha globale të firmave të auditimit. Sesiioni do të ofrojë edhe një perspektivë nga pikëpamja praktike, duke marrë parasysh përvojën e Austrisë. Prezantimi do të pasohet me pyetje dhe përgjigje.

13:00

## Dreka

<sup>3</sup> <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=14227>

14:00

## Praktikat e vogla dhe të mesme si këshilltarë të besuar për subjektet e vogla dhe të mesme

### Folësit [me video]

- **David Madon**, Drejtor, Qëndrueshmëria, Politikat dhe Çështjet Rregullative, FNK
- **Christopher Arnold**, Drejtor dhe Kryesues për NVM/PVM dhe Hulumtime, FNK

### Moderator

- **Iwona Warzecha**, Specialiste e lartë e menaxhimit financiar, Udhëheqëse e Ekipit në REPARIS for SMEs, Banka Botërore

### Temat në fokus

Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit, veçanërisht PVM-të, po përballen me sfida dhe kërkesa të reja që shkojnë përtej raportimit të pastër financiar dhe menaxhimit financiar për të mbuluar pajtueshmërinë me objektivat MSQ dhe raportimin e qëndrueshmërisë. PVM-të si këshilltarë të besuar për NVM-të pritet të ofrojnë më shumë shërbime me vlerë të shtuar për më pak në një kohë më të shkurtër. Ky sesion do të diskutojë: (i) se si profesioni, me mbështetjen e organizatave profesionale të kontabilitetit (PAO) dhe FNK, mund të përgatisë dhe të ndërtojë kapacitete për t'iu përgjigjur përgjegjësive dhe kërkesave të reja, në veçanti për t'i shërbyer NVM-ve; dhe (ii) rolin model për PVM-të në ofrimin e mbështetjes së biznesit për NVM-të duke përfshirë teknologjinë dixhitale dhe përgjegjësitë MSQ. Informacioni mbi burimet e NVM/PVM të FNK mbi transformimin e praktikës, duke përfshirë raportimin e qëndrueshmërisë dhe dixhitalizimin, do të shpërndahet gjithashtu.

14:45

## STAREP: Mësimet e nxjerra dhe përvoja e vendeve përfituese

### Folësit

- **Përfaqësues të Vendeve Përfituese**, Armenia, Azerbajxhani, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina
- **Dan Boyce**, Menaxher i praktikës për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, Praktika Globale e Qeverisjes, Udhëheqës i Komisionit Drejtues në PULSAR, Banka Botërore

### Moderatorët

- **Garik Sergeyan**, Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Drejtues i Ekipit STAREP, QRRF, Banka Botërore
- **Svetlana Platon**, Konsulente, Banka Botërore

### Temat në fokus

Programi STAREP ka ndihmuar vendet përfituese të nisin dhe zbatojnë reforma kritike për të përmirësuar kuadrin e tyre të raportimit financiar: forcimin e praktikave të menaxhimit financiar në sektorin privat dhe midis ndërmarrjeve shtetërore; rritja e cilësisë së këshillimit dhe auditimit të biznesit nga profesioni i kontabilitetit dhe auditimit; dhe duke mbështetur një mjedis më të favorshëm që mundëson biznes dhe qasje të përmirësuar në financa. Ky sesion do të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të mësimëve të nxjerra nga STAREP dhe do të informojë mbi rezultatet e përgjithshme të projektit. Vendet përfituese do të ftohen më pas të ndajnë arritjet kombëtare në fushën e kontabilitetit dhe auditimit që u mbështetën nga STAREP dhe gjithashtu sfidat e mbetura dhe planet e tyre në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të raportimit financiar të korporatave, duke përfshirë kërkesat e qëndrueshmërisë.

15:30

## Kafe dhe pushim për rrjetëzim

16:00

## REPARIS for SMEs: Mundësi për rritje të mëtejshme të Raportimit Financiar të Korporatave

### Folësit

- **Iwona Warzecha**, Specialiste e Lartë e Menaxhimit Financiar, Udhëheqëse e Ekipit në REPARIS for SMEs, Banka Botërore
- **Përfaqësues të Vendeve Përfituese**, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia

### Moderatorët

- **Andrei Busuioc**, Specialiste e Lartë e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore
- **Svetlana Platon**, Konsulent, Banka Botërore

### Temat në fokus

Ky sesion do të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve që do të mbështeten në kuadër të REPARIS for SMEs, veçanërisht në lidhje me përafrimin e kornizave ligjore kombëtare dhe praktikave në raportimin financiar dhe auditimin me kërkesat e BE-së. Vendet përfituese do të ftohen të përshkruajnë statusin aktual të kontabilitetit dhe auditimit dhe fushat e tyre të fokusit për reformat që do të mbështeten nga projekti rajonal që do të ketë një ndikim të përgjithshëm mbi NVM-të. Do të ketë diskutime për të rënë dakord mbi hapat e ardhshëm për programin, duke përfshirë datat dhe temat për ngjarjen e ardhshme rajonale dhe produktet e njohurive.

17:00

## Konkludimet e takimit

### Folës

- **Dan Boyce**, Menaxher i Praktikave të Qeverisjes, Banka Botërore

17:15

## Fundi i punëtorisë

19:00

22:00

## Darka në grup në Kahlenberg

QRRF KREMTON  
15-VJETORIN E  
THEMELIMIT SI PJESE  
E KONFERENCËS  
MINISTRORE 2022



STAREP BASHKËFINANCOHET NGA

 Austrian  
Development  
Cooperation

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

REPARIS FOR SMEs FINANCOHET NGA



European Union

